




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 12 tetor 2022



Nr. 4481/22
Data. 14.10.22

Për: Z. Alpin Dogan, Drejtor Menaxhues KEDS SH.A.

Nga: Z. Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Lënda: Njoftim lidhur me shkeljet e konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga KEDS SH.A.

I nderuari z. Dogan,

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka përfunduar Raportin lidhur me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga KEDS SH.A., të cilin janë prezantuar Bordit të ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.06.2022.

Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit të Raportit dhe përgjigjeve të pranuar nga KEDS, ka nxjerrë Njoftimin lidhur me shkeljet e konstatuara në lidhje me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga KEDS SH.A., dhe në pajtim me dispozitat e nenit 57 paragrafi 7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ju njofton se mund të përgjigjeni me shkrim për shkeljet e gjetura, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga pranimi i këtij Njoftimi.

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni Njoftimin lidhur me shkeljet e konstatuara në lidhje me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga KEDS SH.A.

Me respekt,

Ymer Fejzullahu,
Kryesues i Bordit të ZRRE-së.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



12 tetor 2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 9, Nenin 16, Nenin 25, Nenin 55 par. 1, nënpar. 1.5, Nenin 56 par. 1 nënpar. 1.2, dhe Nenin 57 par. 7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Nenin 28 par. 1 nënpar. 1.3, 1.17 dhe 1.21 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, Nenin 9 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike, Nenin 11.1.9 të Rregullave të Tregut, Nenin 2.5.1.2 të Kodit të Balancit, Nenin 3, Nenin 4, Nenit 5, Nenin 7 dhe Nenin 8 dhe Nenin 9 par. 6 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, Nenin 3, Nenin 5 par. 2, Nenin 9 par. 2, Nenin 23 dhe Nenin 32 të Licencës Nr. ZRRE/Tr_06/17 për KEDS SH.A., ka shqyrtuar komentet e “KEDS” SH.A., ndaj Raportit të Monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nomimimet për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS), dhe në mbledhjen e mbajtur me **12 tetor 2022** ka nxjerr këtë:

NJOFTIM

Lidhur me shkeljet e konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nomimimet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A.)

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në përputhje me kompetencat e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka bërë monitorimin në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nomimimet për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS).

Monitorimi ishte në mbledhjen, vlerësimin dhe analizimin e të dhënave dhe të pajtueshmërisë në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet ekonomike dhe financiare, transaksionet dhe informacionet janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe kornizën rregullative në fuqi.

Qëllimi ishte fokusuar në evidentimin e devijimeve nga parimet e ligjshmërisë, mbi:

- Faturimin dhe Pagesat ndërmjet të Licencuarve;
- Blerjet e importit nga FSHU (KESCO) dhe Procesin e shitjes së energjisë nga Importi për mbulim të humbjeve tek OSSH (KEDS), si dhe
- Devijimet në nominimin e energjisë të KEDS për humbje.

ZRRE, në kuadër të monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nomimimet për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS) ka përgatitur një raport me të gjeturat të cilin ja ka prezantuar Bordit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.06.2022, ka shqyrtuar të gjeturat në Raportin e përgatitur nga ekspertët e ZRRE-së dhe më datë 24.06.2022, përmes dokumentit *Raporti i Monitorimit* në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nomimimet për operatorin e sistemit të



shpërndarjes (KEDS) dhe furnizuesin me energji elektrike (KESCO), ka njoftuar palën lidhur me të gjeturat e monitorimit.

Poashtu, Bordi i ZRRE-së, bazuar në Nenin 7 par. 2 të Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat, ka kërkuar nga "KEDS" sh.a. që në afat prej 15 ditë kalendarike të ofroj përgjigjet me shkrim lidhur me të gjeturat në raport.

"KEDS" sh.a, me datë 08.07.2022 ka dërguar Komentet në Raportet e Monitorimit për blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nomimimet për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS) të datës 24.06.2022, duke paraqitur përgjigjet në të gjeturat dhe konstatimet e evidentuara nga Raporti i Monitorimit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 ka shqyrtuar përgjigjet/komentet e dërguara nga "KEDS" sh.a, ndaj *Raporti i Monitorimit për* në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nomimimet për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS), dhe ka konstatuar si në vijim:

- KEDS nuk ka prokuruar energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve siç parashihet me dispozita ligjore, respektivisht paragrafin 1.21 të Nenit 28 të Ligji Nr 05/L-085 për Energjinë Elektrike si dhe Nenit 9 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë;
- KEDS nuk ka ushtruar përgjegjësitë të dhëna me këtë legjislacion i cili obligon OSSH-në, të siguroj energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jo diskriminimit;
- KEDS, ka nominuar sasi më të vogla të energjisë për humbje e rrjetit të shpërndarjes se sa vet parashikimi i tij. Dështimi i KEDS-it për të nominuar energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në shpërndarje ka rritur shkallën e devijimeve në nivelin e interkonkesionit, duke shkaktuar pasoja financiare; dhe
- KEDS, nuk ka vepruar sipas Nenit 28 paragrafit 1.3 dhe 1.17 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nenit 11.1.9 të Rregullave të Tregut, Nenit 2.5.1.2 të Kodit të Balancit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes lëshuar nga ZRRE.

Andaj, bazuar në konstatimet e cekura më lartë, Bordi i ZRRE-së vlerëson se konstatimet e lartcekura janë bazë e mjaftueshme për aplikim e dispozitave ndëshkimore të përcaktuara me Nenit 57 paragrafi 2 nënparagrafet 2.8 dhe 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe Nenit 9 par. 1 nënpar. 1.8 dhe 1.14 të Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat, si dhe dispozitave ligjore të cekura në hyrje të këtij njoftimi.

Bordi i ZRRE-së, në pajtim me dispozitat e Nenit 57 paragrafi 7 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, lëshon këtë **NJOFTIM**, me të cilin ju njofton se mund të përgjigjeni me shkrim për shkeljet e gjetura, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga pranimi i këtij njoftimi.

Në emër të Bordit të ZRRE-së;

Ymer Fejzullahu

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

